Vendim nr. 290, datë 16.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 16.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (E) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ERION ÇEREKJA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3602 akti, datë 16.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1170, datë 24.11.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1454, datë 30.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Erion Çerekja, në vitin 2014 ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me disa shoqëri investitore për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe totale 160,5 m² dhe të një njësie tregtare me sipërfaqe totale 127,4 m², përfshirë sipërfaqet e përbashkëta përkatëse. Duke pretenduar ndryshime thelbësore nga projekti dhe kushtet kontraktore, në datën 02.02.2018 ai i është drejtuar gjykatës me padi kundër shoqërive investitore, duke kërkuar përmbushjen e kontratës dhe dorëzimin e sendeve sipas sipërfaqeve të përcaktuara në të, si dhe shpërblimin e dëmit dhe uljen e çmimit për shkak të të metave të sendeve.

2. Gjatë shqyrtimit të çështjes civile, me qëllim sqarimin e rrethanave që lidheshin me pretendimet e kërkuesit, gjykata ka caktuar eksperten E.G. për kryerjen e një ekspertimi. Pas përgatitjes nga ajo të aktit të ekspertimit dhe njohjes me këtë akt, kërkuesi e ka kundërshtuar atë, duke pretenduar se përmbante të dhëna dhe matje të pavërteta, konstatime të bëra pa këqyrur sendet dhe vlerësime jashtë fushës së ekspertizës së saj, si dhe nuk i kishte dhënë përgjigje pyetjes për sipërfaqen e përbashkët. Sipas tij, ekspertja kishte vepruar me qëllim favorizimin e palës kundërshtare dhe veprimet e saj përbënin ekspertim të rremë.

3. Ndërkohë që procesi civil vijonte, kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj ekspertes për veprën penale "Ekspertimi i rremë", të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal (*KP*). Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 31.05.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Sipas prokurorisë, ekzistenca ose jo e veprës penale të ekspertimit të rremë mund të vlerësohej vetëm pas përfundimit të procesit civil me vendim të formës së prerë.

4. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në gjykatë, duke pretenduar se ishte i paligjshëm dhe i pabazuar në prova, pasi procesi civil nuk pengonte zhvillimin e hetimeve penale. Gjithashtu, ai ka pretenduar se gjykata civile nuk kishte kompetencë për të konstatuar gabimet në aktin e ekspertimit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3602 akti, datë 16.10.2019, ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkuesit, duke vlerësuar se vendimi i prokurorisë ishte i mbështetur në ligj dhe në prova. Sipas saj, pretendimet e kërkuesit lidheshin me mangësi të aktit të ekspertimit, të cilat mund të shqyrtoheshin në procesin civil përmes mjeteve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile (*KPC*), pa u evidentuar elemente të ndonjë vepre penale që kërkonin hetim nga prokuroria. Gjykata ka theksuar se vendimi i prokurorisë mund të rishikohej sipas Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) në varësi të vendimmarrjes së gjykatës civile. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1170, datë 24.11.2022, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas saj, nuk rezultonin elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 309 i KP-së, pasi nuk evidentoheshin veprime të kryera me dashje nga ekspertja për paraqitjen e rezultateve të rreme. Gjykata e apelit ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit lidheshin me vlerësimin e aktit të ekspertimit si provë në procesin civil, ku ai mund ta kundërshtonte atë dhe të kërkonte ekspertim shtesë ose të ri. Në këtë drejtim ajo ka theksuar se mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën civile. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1454, datë 30.09.2025, të marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat e faktit kishin arsyetuar në mënyrë shteruese ligjshmërinë e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe u kishin dhënë përgjigje pretendimeve të ankuesit. Sipas tij, gjykatat e faktit kishin vlerësuar drejt mjaftueshmërinë e veprimeve verifikuese të prokurorisë dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes së saj, në përputhje edhe me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, ndërsa nga aktet nuk rezultonin veprime të ekspertes që të evidentonin elementet e veprës penale të kallëzuar ose të ndonjë vepre tjetër penale.

8. Në datën 05.03.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 23.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor,* në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së mbrojtjes, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* pasi mosnjoftimi për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë i ka mohuar mundësinë për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur qëndrimin e tij për shkeljet procedurale, interpretimin e nenit 309 të KP-së dhe mangësitë e arsyetimit të kundërshtuara në

rekurs. Në këtë mënyrë ai është vendosur në pozitë të pabarabartë me organin e akuzës. Gjithashtu, ushtrimi efektiv i së drejtës së rekursit është cenuar, pasi vendimi i gjykatës së apelit, i shpallur në datën 24.11.2022, i është komunikuar vetëm në datën 03.03.2023, ndërkohë që ai nuk kishte marrë pjesë në gjykim.

9.2. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi gjykatat e zakonshme kanë dhënë vendime të pabazuara në ligj, kontradiktore dhe alogjike. Megjithëse organi i akuzës dhe gjykatat kanë pranuar cenimin e të drejtave të tij të ligjshme, ato e kanë trajtuar çështjen si mosmarrëveshje civile. Gjykatat nuk kanë shqyrtuar argumentet për falsitetin e aktit të ekspertimit, veçanërisht për koeficientin e sipërfaqes së përbashkët, llogaritja e së cilës ka sjellë rritjen fiktive të çmimit dhe një dëm ekonomik prej 67.488 eurosh. Kjo diferencë përbën të paktën indicie të arsyeshme për pasqyrimin e të dhënave të pavërteta dhe ekspertja ka vepruar me dashje, duke përmbushur elementet e veprës penale. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me një arsyetim formal, të ngushtë dhe kontradiktor, pa u dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore me natyrë kushtetuese.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

10. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre mjafton për të penguar kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të

ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mbi këtë bazë, në rastin konkret, Kolegji do të verifikojë plotësimin e kriterit të legjitimimit *ratione personae* të kërkuesit.

12. Për sa i përket këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë material (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal ndaj ekspertes së caktuar nga gjykata në procesin civil për veprën penale "Ekspertimi i rremë", të parashikuar nga neni 309 i KP-së. Duke qenë se ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, Kolegji vlerëson se kërkuesi e justifikon interesin e tij në aspektin procedural.

13. Për sa i përket aspektit material të këtij kriteri, Gjykata ka pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, duke treguar se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat e aktit të kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin e tij kushtetues, duke treguar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë sjellë pasoja vetjake, të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij themelore.

14. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuesit lidhen me veprimet e ekspertes së caktuar në procesin civil, e cila, sipas tij, ka pasqyruar të dhëna të pavërteta, ka shtrembëruar matjet dhe konstatimet faktike, si dhe ka shprehur vlerësime që dalin jashtë fushës së ekspertizës së saj. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se KPC-ja parashikon mjete procedurale për kundërshtimin e aktit të ekspertimit dhe verifikimin e përfundimeve të tij në kuadër të procesit civil. Konkretisht, sipas nenit 224/a të KPC-së, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen kërkohen njohuri të posaçme. Sipas nenit 224/b të po këtij kodi, mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën, e cila, nëse arrin në përfundime të kundërta me mendimin e tij, duhet të arsyetojë me hollësi qëndrimin e saj. Po kështu, neni 229 i KPC-së parashikon se, kur ekspertimi rezulton i metë ose i paqartë, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjërës nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë.

15. Në këtë kuadër, Kolegji vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në kallëzimin penal përpara gjykatave të zakonshme dhe në ankimin kushtetues individual lidhen, në thelb, me

përmbajtjen dhe përfundimet e aktit të ekspertimit, i cili ishte objekt shqyrtimi dhe debati në procesin civil. Kërkuesi nuk ka parashtruar argumente konkrete që të tregojnë se vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë penguar të kundërshtojë aktin e ekspertimit, të kërkojë sqarime plotësuese ose kryerjen e një ekspertimi të ri në atë proces. Ndonëse mundësia e përdorimit të këtyre mjeteve nuk e përjashton përgjegjësinë e mundshme penale të ekspertit, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka argumentuar se rezultati i procedimit penal të kërkuar ishte përcaktues për zgjidhjen e pretendimeve të tij pasurore në procesin civil ose se vendimet e kundërshtuara kanë penguar mbrojtjen e tyre. Në këtë drejtim, pretendimi për dëm ekonomik, që kërkuesi ia atribuon përmbajtjes së aktit të ekspertimit, nuk tregon sesi mosfillimi i procedimit penal ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale në ushtrimin e të drejtave të tij. Për rrjedhojë, në lidhje me interesin pasuror të parashtruar, kërkuesi nuk ka treguar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet vendimeve gjyqësore të kundërshtuara dhe cenimit të pretenduar të të drejtave të tij kushtetuese.

16. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se Kushtetuta nuk garanton një të drejtë autonome për të kërkuar ndjekjen ose dënimin penal të personave të tretë. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se një e drejtë e tillë nuk garantohet nga KEDNJ-ja (*shih Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, vendim për pranueshmërinë, nr. 45320/99, datë 19.09.2006*). Në lidhje me zbatueshmërinë në kontekstin e procedurave penale të nenit 6 të KEDNJ-së në aspektin e tij civil, GJEDNJ-ja ka theksuar se kjo kushtëzohet: *së pari*, nga ekzistenca e një të drejte civile materiale (substanciale), siç është ajo për shpërblimin e dëmit të pësuar, të njohur nga e drejta e brendshme; *së dyti*, nga njohja, po në të drejtën e brendshme, të së drejtës procedurale të viktimës së një vepre penale për të ngritur padi me qëllim realizimin e asaj të drejte civile në fazën përkatëse të procedurave penale. Sipas GJEDNJ-së, që neni 6 në aspektin civil të jetë i zbatueshëm në kuadër të procedurave penale, e drejta civile duhet të jetë kërkuar dhe/ose ndjekur nëpërmjet rrugës së përshtatshme procedurale, në përputhje me parimet dhe rregullat e kuadrit të brendshëm ligjor. Megjithatë, kjo nuk cenon mundësinë e asaj gjykate që të vlerësojë nëse veprimet për të kërkuar dhe/ose ndjekur realizimin e së drejtës civile në fjalë kanë qenë *prima facie* të pavlefshme nga pikëpamja procedurale ose materiale, ose se përpjekja për të paraqitur pretendime të tilla përmes rrugës penale ka qenë e papërshtatshme ose abuzive, si, për shembull, në rastet kur çështja është thjesht e natyrës civile ose kanë përfunduar afatet e parashkrimit ose afate të tjera të zbatueshme. Gjithashtu, neni 6 zbatohet nëse e njëjta e drejtë civile nuk është duke u ndjekur në mënyrë aktive në një proces paralel përpara një gjykate tjetër. Së fundi, por me rëndësi të njëjtë, procedimi penal duhet të jetë vendimtar për përcaktimin ose realizimin e së drejtës civile në fjalë

(*shih Fabbri dhe të tjerë kundër San Marinos [DHM], datë 24.09.2024, §§ 88-93*). Po kështu, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kundërshtimi gjyqësor i vendimit për mosndjekjen penale të një personi tjetër, nuk synon, në vetvete, përcaktimin e "të drejtave dhe detyrimeve civile" dhe kur nuk ndikon as në mundësinë e individit për të ngritur padi për dëmshpërblim, nuk përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 6 të Konventës, në aspektin civil *(shih Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë [DHM], datë 14.04.2015, § 218*).

17. Në këtë kuptim, interesi i individit për ndjekjen penale të një personi të tretë mund të marrë rëndësi kushtetuese kur lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e një të drejte të tij themelore dhe kur akti i kundërshtuar ka sjellë pasoja vetjake, të drejtpërdrejta dhe reale në ushtrimin e kësaj të drejte.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të tregojë se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij kushtetuese. Paraqitja e kallëzimit penal ndaj ekspertes dhe kundërshtimi gjyqësor i vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal justifikojnë interesin e tij procedural, por nuk mjaftojnë për të provuar ekzistencën e një interesi kushtetues në aspektin material. Në rrethanat e kësaj çështjeje, kërkuesi nuk ka treguar se procesi i kundërshtuar ishte përcaktues për mbrojtjen e të drejtave të tij pasurore, as që ai pengonte vazhdimin e procesit civil dhe as se mosfillimi i procedimit penal ka cenuar ndonjë të drejtë tjetër themelore, të lidhur drejtpërdrejt me objektin e atij procesi. Për këtë arsye, pretendimet për parregullsi procedurale gjatë shqyrtimit të ankimeve kundër vendimit të prokurorit nuk mjaftojnë për të justifikuar interesin material të kërkuesit në gjykimin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, pasi nuk ka arritur të justifikojë interesin e tij kushtetues në aspektin material.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.